

**STATUTI I SHOQËRISË
“Oferta Ditës” sh.p.k.**

**KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Forma ligjore dhe emri i shoqërisë**

1.1. **“Oferta Ditës” sh.p.k.** themelohet ne bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Aktin e Themelimit të shoqërisë, nënshkruar nga Ortaku i tij.

1.2 Shoqëria **“Oferta Ditës” sh.p.k.** mund të përdorë emrin **“Oferta Ditës” sh.p.k.** ose emrin tregtar **Ofertadites**.

1.3. **“Oferta Ditës” sh.p.k.** themelohet dhe operon si shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” (sh.p.k.). Këtu e më poshtë në këtë Statut, shoqëria **“Oferta Ditës” sh.p.k.** do të referohet vetëm si shoqëria.

1.4. Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik dhe të drejtën për të ushtruar aktivitetet si dhe për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, vetëm pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

1.5. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me objektin e përcaktuar në këtë Statut, bazuar në legjislacionin shqiptar, në këtë Statut si dhe Aktin e Themelimit.


**Neni 2
Ortakët**

2.1. Shoqëria themelohet nga Ortaku i mëposhtëm; Z. Shaqir Kërtusha, lindur në Durrës, Shqipëri, në 26.07.1989, mbajtës i letërmjostimit Nr. 035025512, lëshuar nga Ministria e Brendshme në datën 31.10.2019 dhe e vlefshme deri në datën 30.10.2029, me Nr. Personal I90726074T, banues në Durrës, Shqipëri.

2.2. Ortakët janë përgjegjës për mbulimin e humbjeve të shoqërisë vetëm deri në vlerën e kapitalit të shoqërisë.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, në përputhje me objektin, për një periudhë kohore pa afat, që fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



Neni 4
Selia

4.1. Selia e shoqërisë do të jetë në Rrugën Nail Kondi, Objekti Nr. 4005, Kati I, Durrës, Shqipëri.

4.2. Shoqëria mund të themelojë degë ose zyra përfaqësimi, brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5
Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë, përfshirë dhe pa u limituar:

- Publikimi, marketing dhe shërbime shitblerje nëpërmjet platformës online www.ofertadites.com, duke u mundësuar palëve të treta të interesuara publikimin e fotove, të dhënavë të produkteve si dhe kontakteve për realizimin e shitjeve të produkteve ose shërbimeve.
- Regjistrimi dhe administrimi i faqeve të internetit (website) për shitjen e produkteve jo-ushqimore online në Shqipëri dhe jashtë saj.
- Programimi i faqeve internet (WebDesign-Development) si dhe mirëmbajtjen e tyre, shërbime konsulencë dhe marketingu, menaxhim i aktiviteteve lidhur me to.
- Prodhimi dhe shpërndarja në rrugë elektronike e materialeve me përbajtje promocionale, foto, audio-video si dhe krijimi i materialeve të ndryshme me përbajtje vizive, në veçanti broshura, menu, fletë-palosje si dhe oferta për produkte të ndryshme të shoqërive tregtare, vendase dhe të huaja.
- Konsulencë dhe trajnime të ndryshme në fushën e Marketing. Zhvillim tregtie nëpërmjet online websites, sipas konceptit Market-Place.
- Ndërmjetësim, orientim, mbështetje dhe lehtësim të procedurave lidhur me procesin e blerjes nga individët/subjektet të mallrave dhe shërbimeve të ofruara nga shoqëritë tregtare me të cilat do të bashkëpunojë kjo shoqëri në reklamimin e këtyre të fundit.
- Tregti online dhe offline të produkteve të ndryshme.
- Shoqëria ka si objekt veprimtarie kryerjen e të gjitha veprimtarive që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të ligjit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë si dhe çdo formë e aktiviteteve ligjore dhe komerciale që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë.

KAPITULLI II
KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 6
Kapitali themelues

6.1. Kapitali themelues i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë, që përfaqësohet nga 1 (një) kuotë.



6.2. Pjesëmarra e ortakut në Kapitalin themelues të shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij: Z. Shaqir Kërtusha është pronar i vetëm i kuotës në vlerën prej 100,000 (njëqind mijë) lekë, të cilat përfaqësojnë 1 (një) kuotë të Kapitalit themelues me 100% të kapitalit të shoqërisë.

6.3. Kuotat janë nominale dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.

6.4. Çdo kuotë perfaqëson të drejtën për një votë.

Neni 7

Rregjistrimi i kuotave të Kapitalit themelues

7.1. Kuotat dhe pronari i tyre, si dhe të dhënat e tjera lidhur me Kapitalin themelues, rregjistrohen në rregjistrin e veçantë.

7.2. Forma dhe modelet e rregjistrimit miratohen me vendimin e Ortakëvc që përfaqësojnë $\frac{1}{4}$ e kuotave.

Neni 8

Transferimi i kuotave të Kapitalit themelues

Transferimi i kuotave të Kapitalit themelues brenda ortakëve të shoqërisë mund të kryhet lirisht, ndërsa transferimi tek palët e treta mund të kryhet vetëm me miratimin e vendimit të Ortakëve që përfaqësojnë $\frac{1}{4}$ e kuotave.

Neni 9

Transferimi i kuotave të Kapitalit themelues nëpërmjet trashëgimisë

9.1. Transferimi i kuotave të Kapitalit themelues mund të kryhet lirisht dhe pa asnjë kufizim në këtë Statut, nëpërmjet trashëgimisë si dhe në rastet e ndarjes së pasurisë ndërmjet bashkëshortëve.

9.2. Transferimi i kuotave të Kapitalit themelues mund të kryhet lirisht dhe pa asnjë kufizim në këtë Statut, ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet prindërvës dhe fëmijëve si dhe vice versa.

Neni 10

Akti i transferimit të kuotave të Kapitalit themelues

10.1. Në çdo rast, transferimi i kuotave të Kapitalit themelues nëpërmjet testamentit të Ortakut duhet që të çertifikohet nga një noter publik.

10.2. Transferimet e kuotave të Kapitalit themelues reflektohen në rregjistrin e kuotave, siç miratuar në përputhje me Nenin 7 të këtij Statuti. Mos-reflekimi i transferimit të kuotave në këtë rregjistër, nuk e bën të pavlefshëm aktin e transferimit.

10.3. Akti i transferimit të kuotave të Kapitalit themelues duhet që të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit brenda një muaji nga data e rregjistrimit të këtij akti në noterin publik.

10.4. Kërkesa për depozitim e aktit të shit-blerjes së kuotave të Kapitalit themelues duhet që të përfaqësohet nga shitësi, blerësi ose përfaqësuesi i autorizuar.



Neni 11
Zmadhimi ose zvogēlimi i kapitalit

11.1. Kapitali themelues i shoqērisë mund tē zmadhohet nēpērmjet kontributit nē vlera monetare ose nēpērmjet kontributit nē natyrë i cili pēraktihet nē pērputhje me vendimin e Asamblesë sē Pērgjithshme.

11.2. Zvogēlimi i kapitalit themelues tē shoqērisë lejohet nga Asambleja e Pērgjithshme, e cila e merr vendimin nē pērputhje me tē njējtēn procedure qē kērkohet pēr ndryshimin e Statutit tē shoqērisē.

KAPITULLI III
ORGANET DREJTUESE TĒ SHOQĒRISĒ

Neni 12
Organet drejtuese

Organit drejtues mē i lartē i shoqērisē ēshtë **Asambleja e Pērgjithshme**.

Neni 13
Asambleja e Pērgjithshme

13.1. Funksionet dhe kompetencat

Asambleja e Pērgjithshme operon nē pērputhje me legjislacionin shqiptar dhe merr vendime, pērfshirë dhe pa u limituar, nē pēraktimin e politikave tregtare tē shoqērisë, amendimin e Statutit, emōrimin dhe shkarkimin e administratorëve, likuidatorëve, Audituesve Ligjorë, mbikqyrjen e implementimit tē politikave tregtare nga administratorët, themelimin e degëve tē reja, miratimin e pasqyrave financiare dhe raportet e progresit tē shoqērisë, zmadhimin dhe zvogēlimin e kapitalit, riorganizimin dhe prishjen e shoqērisë si dhe çështje tē tjera siç pēraktohen nga legjislacioni pērkatës.

13.2. Mbledhja e Asamblesë sē Pērgjithshme

Asambleja e Pērgjithshme mblidhet nē rastet e pēraktuara nē ligj, Statut dhe nē çdo rast qē takimi konsiderohet si i nevojshëm pēr tē mbrojtur interesat e shoqērisë.

Asambleja e Pērgjithshme thirret nga administratorët ose Ortakët qē pērfaqçsojnë tē paktën 5% tē totalit tē Asamblesë sē Pērgjithshme tē shoqērisë. Nē rastet kur Asambleja e Pērgjithshme thirret nga Ortakët e shoqērisë, ata mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, pērfshirë postën elektronike, pēr tē thirrur Asamblenë e Pērgjithshme dhe/ose pērfshirjen e çështjeve tē posaçme nē rendin e ditës.

13.3 Vendi i mbledhjes sē Asamblesë sē Pērgjithshme

Mbledhja e Asamblesë sē Pērgjithshme zhvillohet nē vendet e pēraktuara nga Ortakët. Nē rast se vendi i takimit nuk është pēraktuar nē thirrjen e takimit, takimi zhvillohet nē selinë e shoqērisë.

13.4 Mënyrat e thirrjes sē mbledhjes sē Asamblesë sē Pērgjithshme



Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas kësaj procedure, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

13.5 Vendimarrja

Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, vendimet merren nga Ortakët që kanë një përqindje të caktuar vote.

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë të paktën 50.01% të kuotave. Në këtë rast, vendimet konsiderohen si të miratuar me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve që janë prezent, personalisht ose të përfaqësuar.

Në rastin e marrjes së vendimeve të Asamblecsë së Përgjithshme që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, si për rastet e amendimeve te Statutit, zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit themelues, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin ose shuarjen e shoqërisë, kuorumi konsiderohet me prezencën e Ortakëve që zoterojnë të paktën 50.01% të kuotave, dhe në këtë rast vendimarrja konsiderohet e vlefshme me të paktën 75% të kuotave të Ortakëve prezent.

Neni 14 Administratori

14.1. Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.

14.2. Në aktin e emërimit, përcaktohet edhe periudha e ushtrimit te funksionit, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

14.3. Administratori i shoqërisë është Z. Shaqir Kërtusha, lindur në Durrës, Shqipëri, në 26.07.1989, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 035025512, lëshuar nga Ministria e Brendshme në datën 31.10.2019 dhe e vlefshme deri në datën 30.10.2029, me Nr. Personal I90726074T, banues në Durrës, Shqipëri, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

Neni 15 Kompetencat e Administratorit

Administratori i shoqërisë ka këto kompetencia:

- Përfaqëson interesat e shoqërisë ne lidhje me palët e treta;
- Është përgjegjës për administrimin e aktivitetit ditor të shoqërisë;



- Lidh kontrata në emër dhe për llogari të shoqërisë, siç përcaktohet në këtë Statut;
- Përgatit raportin vjeçar për administrimin e shoqërisë, inventarët dhe llogaritë vjeçare;
- Emëron dhe shkarkon personelin e shoqërisë;
- Të tjera, siç përcaktohet në këtë Statut dhe në aktet ligjore/nën-ligjore përkatëse.

Neni 16

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

- 16.1. Administratori është i detyruar që të zbatojë dispozitat e këtij Statuti si dhe aktet e tjera të Asamblesë së Përgjithshme që lidhen me aktivitetin tregtar të shoqërisë;
- 16.2. Administratori është i detyruar që të përgatisë raporte dhe të informojë në lidhje me progresin e shoqërisë, të paktën çdo muaj dhe në çdo rast sipas kërkesës së Ortakëve si dhe të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- 16.3. Administratori ka të drejtë që të shesë dhe blejë pasuri të patundëshme vetëm nëpermjet miratimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme;
- 16.4. Administratori mund të marrë hua në emër të shoqërisë, por në çdo rast, vlera e huasë nuk mund të jetë më e lartë se 100,000 (njëqind mijë) Euro ose vlera përkatëse në monedha të tjera në një vit kalendarik;
- 16.5. Për hua me vlera më të larta se 100,000 (njëqind mijë) Euro ose vlera përkatëse në monedha të tjera në një vit kalendarik, huaja mund të merret vetëm nëpermjet miratimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme që merret me vendimarrje të kualifikuar;
- 16.6. Administratori është i detyruar që të informojë Asamblenë e Përgjithshme për çdo kontratë të lidhur në emër dhc për llogari të shoqërisë me vlerë më të madhe se 100,000 (njëqind mijë) Euro ose vlera përkatëse në monedha të tjera, brenda pesë ditëve kalendarike nga data e lidhjes;
- 16.7. Administratori është i detyruar që të mbrojë dhe të respektojë çdo informacion që lidhet me aktivitetin finanziar dhe ekonomik të shoqërisë, përjashtuar rastet kur këto informacione kërkohen nga autoritetet kompetente me qëllim zbatimin e ligjshmërisë;
- 16.8. Administratori kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- 16.9. Administratori raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- 16.10. Administratori aplikon, në emër dhe për llogari të shoqërisë, pranë të gjitha institucioneve shtetërore përmarrjen e lejeve dhe licencave në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve që përcaktohen në objektin e këtij Statuti.

Neni 17
Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit

- 17.1. Akti i emëritimit dhe shkarkimit të Administratorit duhet që të jetë me shkrim dhe duhet që të përcaktojë periudhen e emëritimit, pagesave etj.
- 17.2. Pas emëritimit të Administratorit, ndërmjet tij dhe Asamblesë së Përgjithshme lidhet kontrata e punësimit, ku të gjitha të drejtat dhe detyrimet e të dy palëve përcaktohen qartësisht.
- 17.3. Administratori mund të shkarkohet në rastet kur nuk përbush detyrimet që burojnë nga dispozitat e Statutit, kontrata e punësimit, dhe çdo akt tjetër ligor që lidhet me këtë funksion.
- 17.4. Administratori mund të shkarkohet kur humbet besimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 17.5. Akti i shkarkimit të Administratorit duhet që të jetë me shkrim dhe duhet që të përfshijë edhe arsyet e shkarkimit.
- 17.6. Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit përfundojnë menjëherë me komunikimin e aktit të shkarkimit.

Neni 18
Personeli i shoqërisë

- 18.1. Personeli i shoqërisë emërohet dhe shkarkohet me vendim të Administratorit në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, Statutit të shoqërisë dhe akteve të tjera të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- 18.2. Numri i të punësuarve, struktura organike si dhe niveli i pagave, miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me propozim të Administratorit.
- 18.3. Administratori duhet që të informojë Asamblenë e Përgjithshme çdo tre muaj për numrin e të punësuarve në shoqëri.

KAPITULLI IV
VITI FINANCIAR, RAPORTET VJEÇARE, FITIMI

Neni 19
Viti finanziar

- 19.1. Llogaritja e shpenzimeve, të ardhurave dhc fitimeve kryhet për çdo vit finanziar.
- 19.2. Çdo vit finanziar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor.

Neni 20
Raportet vjeçare

- 20.1. Administratori prezanton raportin finanziar vjeçar brenda dy muajve nga data e përfundimit të vitit finanziar.



- 20.2. Raporti përmban të dhëna mbi shpenzimet, të ardhurat si dhe çdo informacion tjeter finanziar të shoqërisë.
- 20.3. Asambleja e Përgjithshme miraton raportet financiare dhe llogaritë vjeçare brenda gjashtë muajve nga data e përfundimit te vitit finanziar, dhe në çdo rast, në përputhje me afatin përkatës ligor në fuqi.

Neni 21
Fitimi i shoqërisë

- 21.1. Fitimi llogaritet në fund të çdo viti finanziar.
- 21.2. Shpërndarja e fitimit kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, pasi "rezerva ligjore" eshte përllogaritur dhe nuk është përfshirë në shpërndarje.
- 21.3. Asambleja e Përgjithshme mund të disponojë lirisht fitimin e shoqërisë, pasi ka përllogaritur dhe lënë mënjanë "rezervën ligjore" dhe shlyer të gjitha detyrimet që shoqëria ka ndaj organeve shtetërore.

KAPITULLI V
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 22
Prishja e shoqërisë

- 22.1. Shoqëria prishet për arsyet e përcaktuara në ligj dhe për çdo arsyen tjetër që komplikon ose e bën të pamundur vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë.
- 22.2. Vendimi për prishjen e shoqërisë duhet që të jetë me shkrim dhe të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 22.3. Në rastet kur kapitali i shoqërisë, bazuar në vlerën e dokumentave finanziarë përkatës, është më i vogel se gjysma e kapitalit themelues, shoqëria konsiderohet e prishur.

Neni 23
Likuidimi i shoqërisë

- 23.1. Në rastet e falimentimit, shoqëria kalon në procedurën e likuidimit.
- 23.2. Shoqëria është në proces falimentimi kur nuk ka aftësi paguese ndaj palëve të treta.
- 23.3. Në procesin e likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron një Likuidator, i cili administron shoqërinë deri në përbilljen e procesit të likudimit.
- 23.4. Projekti i likuidimit prezantuar nga Likuidatori miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.
- 23.5. Gjatë procesit të likuidimit, shoqëria përfaqësohet nga Likuidatori, i cili është i autorizuar për të paguar të gjithë kreditorët në përputhje me radhën e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 23.6. Pas përfundimit të procesit të pagimit të kreditorëve, vlerat financiare si dhe çdo kapital i shoqërisë, i dorëzohen Ortakëve.



23.7. Aktet e likuidimit, pas përfundimit, së bashku me raportet përkatëse, depozitohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Pas këtij veprimi, shoqëria shihet nga ky rregjistër.

KAPITULLI VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24 Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Gjykata e Shkallës së Parë, Durrës, është autoriteti përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrveshjeve që mund të lindin gjatë operimit të shoqërisë.

Neni 25 Ndryshimi i Statutit

25.1. Ndryshimi i Statutit mund të kryhet vetëm nëpërmjet një vendimi me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme.

25.2. Ndryshimi është i vlefshëm vetëm nëse është depozituar dhe reflektuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 26 Hyrja në fuqi

Ky Statut është hartuar në 3 kopje në gjuhën shqipe me të njëjtën përbajtje dhe vlerë ligjore dhe, pasi u lexua, kuptua dhe u miratua në parim dhe nen për nen nga ortaku themelues i shoqërisë “Oferta Ditës” sh.p.k., nënshkruhet nga ai dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË “OFERTA DITËS” sh.p.k.

MIRATIMI I KËTIJ STATUTI NGA:

Z. Shaqir Kërtusha

Shaqir Kërtusha

